

Villafalt 5ES

Pastë hidroizoluese me një përbërës

PRODUKTI

Villafalt 5ES është një pastë hidroizoluese me një përbërës, e pasuruar me polimer, rezistente ndaj ujit të ftohtë me një bazë emulzioni bituminoz, e cila nuk përmban lëndë tretëse organike, prandaj është shumë miqësore me mjedisin. Proçesi i prodhimit dhe kontrolli i cilësisë së tij, janë të çertifikuara sipas standartit EN ISO 9001.

KARAKTERISTIKAT E PRODUKTIT

Villafalt 5ES pas proçesit të tharjes, është rezistente ndaj ujit. Për shkak të trajtës së saj si pastë, mund të aplikohet në trashësi të mëdha dhe në sipërfaqe vertikale. Materiali ka veti ngjitëse të shkëlqyer për ngjitjen afatgjatë të fugave të paneleve termoizolues dhe është mjaft fleksibël për të mbushur plasaritjet e holla.



APLIKIMI DHE PËRPUNIMI

Villafalt 5ES është e përshtatshme për hidroizolimet elastike, të përforcuara me fibra xhami, të Villas, sipas standartit austriak ÖNORM B 2209 apo DIN 18195 por është posaçërisht i përshtatshëm për ngjitjen e perimetrit të paneleve termoizolues me shumë. Kur aplikohet në sipërfaqe bituminoze të veshur me fletë, duhet të nxehet paraprakisht me flakë që ngjitja të mund të bëhet më mirë. Sipërfaqja duhet të jetë e thatë, e pastër dhe pa grimca të materialit, pa dhera, vaj ose papastërti të tjera. Të gjitha nënshtresat me bazë minerale duhet të mbulohen me astar Villas Emulbit. Aplikimi bëhet direkt nga kova, pas përzierjes, duke e aplikuar me një mistri ose pajisje tjetër speciale për spruco. Villas Emulbit / Villafalt 5ES duhet të jetë e thatë përpara çdo aplikimi të mëtejshëm (ngjyra: e zezë) Aplikimi nuk duhet të bëhet në rast rreziku nga shiu, ngrica apo rrezet direkte të diellit.

TË DHËNA TEKNIKE

Lëndë tretëse	nuk ka, sepse është emulsion bituminoz (përdoret edhe në ambientet e brendshme)
Ngjyra	e njomë: kafe; e thatë: e zezë
Dendësia	1,1 g/cm ³
Konsistenca	Në formë paste, aplikohet me mistri
Reaksioni	Alkalin
Masë e fortë	rreth 57 % e masës
Koha e tharjes	Në varësi të motit, rreth 24 orë/shtresë
Temperatura e aplikimit	> + 5 °C
Temperatura e përdorimit	> 100 °C
Pregatitja për përdorim	Hollohet me ujë; nuk hollohet me benzinë apo tretës të tjerë organik
Mënyra e pastrimit	e njomë - me ujë, e thatë – me tretësirë terpentine
Paketimi / numri i produktit	Kova nga 25 kg / 106361 10 kg / 106362

Vlerat e dhëna janë nominale dhe subjekt i variacioneve statistikore. I nënshtrohen ndryshimeve teknike. Është detyrim i përdoruesit për të vlerësuar përputhshmërinë e specifikimeve të produktit dhe të sigurohet që ka një version të vlefshëm të fletës së të dhënave teknike.

VILLAFALT 5ES

Botimi: Mars 2012.

MAGAZINIMI

Të mbrohet nga ngrica; e mbrojtur nga ngrica, mund të magazinohet deri në 1 vit. Kovat me materialin e mbetur duhet të mbyllet mirë. Pjesa e mbetur mund të përdoret përsëri.



BMI

VILLAS

www.bmigroup.com